



WVP Fund Management Tirana sh.a

Raport Vjetor 2025

WVP Fund Management Tirana sh.a
Fondi i Investimit WVP Top Invest
Fondi i Investimit WVP Global



Përmbajtja

1. Hyrje
 2. Rreth WVP Fund Management Tirana
 3. Vizioni dhe Misioni
 4. Objektivat Strategjike
 5. Qeverisja Korporative
 6. Transparenca
 7. Procesi i Investimit
 8. Konflikti i Interesit
 9. Trajnimet
 10. Fondet e Investimit dhe Struktura e Portofolit 31.12.2025
 11. Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur
-

1. Hyrje

Të nderuar investitorë,

Me kënaqësi ju paraqesim raportin vjetor të WVP Fund Management Tirana për vitin 2025, i cili përmbledh zhvillimet më të rëndësishme, performancën e fondeve tona dhe përpjekjet tona të vazhdueshme për të ofruar vlerë të qëndrueshme për investitorët.

Viti 2025 ishte i mbushur me turbulenca, rreziqe politike dhe ekonomike, si dhe luhatje të forta në tregjet financiare globale. Pavarësisht këtyre sfidave, fondet tona kanë dëshmuar qëndrueshmëri dhe rezultate pozitive, falë një filozofie investimi të bazuar në disiplinë, analizë të thelluar dhe fokus afatgjatë.

Në këtë raport, do të gjeni një analizë të detajuar të performancës së fondeve tona, përbërjen e portofolit dhe treguesit kryesorë të menaxhimit tonë, të cilët reflektojnë angazhimin tonë për transparencë, profesionalizëm dhe ndërtimin e një baze të fortë për rritje afatgjatë. Ne mbetemi të përkushtuar për t'u ofruar investitorëve tanë një përvojë investimi të besueshme dhe me perspektivë.

Filozofia e Investimit

WVP Fund Management Tirana administron dy fonde investimi: WVP Top Invest dhe WVP Global. Filozofia jonë e investimeve bazohet në krijimin e një portofoli të diversifikuar, që përfshin aksione të kompanive të mëdha dhe me histori të gjatë në tregjet më të zhvilluara të botës.

- **WVP Top Invest:** Ky fond investon në aksione të kompanive të mëdha (Large Caps) të listuara në bursa ndërkombëtare si SHBA, Gjermani, Angli, Francë dhe Zvicër. Monedha e fondit është Lekë dhe synon një periudhë investimi të paktën 10 vite.
- **WVP Global:** Ky fond është në monedhën Euro dhe investon në aksione të kompanive të mëdha në tregjet ndërkombëtare. Fondi është i përshtatshëm për investitorët që kërkojnë diversifikim ndërkombëtar dhe kthime të qëndrueshme.

Rëndësia e Investimit të Rregullt dhe Durimi

Ne theksojmë rëndësinë e investimit të rregullt dhe të qëndrueshëm. Për të përfituar nga rritja e tregut, është thelbësore të mbetemi të investuar dhe të mos spekulojmë me lëvizjet e tregut. Një horizont investimi afatgjatë mbi 10 vite është mënyra më efikase për të krijuar pasuri dhe për të menaxhuar rreziqet.

Perspektiva për vitin 2026

Viti 2026 pritet të sjellë një kombinim të mundësive të reja ekonomike dhe sfidave që kërkojnë vëmendje, disiplinë dhe një qasje të kujdesshme investimi. Megjithëse ekonomia globale vazhdon të ndikohet nga tensionet gjeopolitike, ndryshimet në politikat tregtare, luhatjet e çmimeve të energjisë dhe pasiguritë në tregjet financiare, themelet e zhvillimit afatgjatë mbeten të forta.

Inovacioni teknologjik, rritja e produktivitetit dhe aftësia e kompanive për t'u përshtatur vazhdojnë të krijojnë perspektiva pozitive për ekonominë globale. Revolucioni i inteligjencës artificiale po hap një fazë të re zhvillimi në sektorë të ndryshëm, duke përmirësuar proceset e prodhimit, analizën e të dhënave, shërbimet financiare, kujdesin shëndetësor dhe mënyrën se si kompanitë krijojnë vlerë për klientët dhe aksionarët e tyre.

Sektori i kujdesit shëndetësor pritet të mbetet një ndër fushat më të rëndësishme të rritjes afatgjatë. Plakja e popullsisë, kërkesa në rritje për shërbime mjekësore, zhvillimi i trajtimeve të reja dhe përdorimi i teknologjisë në diagnostikim dhe parandalim krijojnë mundësi të rëndësishme për kompanitë inovative dhe financiarisht të qëndrueshme.

Në të njëjtën kohë, çmimet e naftës dhe energjisë mund të vazhdojnë të luhaten si rezultat i tensioneve ndërkombëtare, vendimeve të vendeve prodhuese dhe pasigurive në zinxhirët globalë të furnizimit. Megjithatë, investimet në energjinë e rinovueshme, sigurinë energjetike dhe diversifikimin e burimeve pritet të mbështesin transformimin afatgjatë të këtij sektori dhe të krijojnë mundësi të reja investimi.

Rreziqet gjeopolitike, konfliktet ndërkombëtare, presionet inflacioniste dhe ndryshimet në politikat monetare do të mbeten faktorë të rëndësishëm gjatë vitit 2026. Megjithatë, historia ka treguar se ekonomia dhe tregjet financiare kanë aftësi të konsiderueshme për t'u përshtatur, për të kapërcyer periudhat e pasigurisë dhe për të krijuar vlerë në afat të gjatë.

Në këtë kontekst, ne e shohim vitin 2026 me optimizëm të matur. Besojmë se kompanitë me baza të forta financiare, modele biznesi të qëndrueshme, pozicion konkurrues dhe aftësi për të investuar në inovacion do të vazhdojnë të ofrojnë mundësi tërheqëse për investitorët afatgjatë.

Si pjesë e **WVP Group Austria**, do të vijojmë të ndjekim me përkushtim filozofinë e investimit të bazuar në vlerë, duke u fokusuar në cilësinë e kompanive, potencialin e tyre afatgjatë dhe diversifikimin e portofolit. Qëllimi ynë mbetet t'u ofrojmë klientëve një alternativë të besueshme dhe profesionale për ruajtjen dhe ndërtimin gradual të pasurisë.

Ne besojmë se durimi, investimi i rregullt dhe ruajtja e një perspektive afatgjatë mbeten ndër parimet më të rëndësishme për suksesin financiar. Periudhat e luhatshmërisë nuk duhet të shihen vetëm si sfida, por edhe si mundësi për të investuar në kompani cilësore me perspektivë të qëndrueshme zhvillimi.

Ju falënderojmë për besimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Me përgjegjësi, profesionalizëm dhe optimizëm, do të vazhdojmë të punojmë për mbrojtjen e interesave dhe realizimin e objektivave afatgjata të investitorëve tanë.

Me respekt,
Arton Lena, CEO

2. Rreth WVP Fund Management Tirana

WVP Fund Management Tirana sh.a është një shoqëri për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, e themeluar më datë 24 janar 2017 dhe e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më 31 janar 2018. Selia jonë ndodhet në Rrugën e "Barrikadave", nr. 118, kati 4, ap. 1, Tiranë, Shqipëri.

Ne jemi pjesë e WVP Group Austria, pionier në tregun e ofrimit të shërbimeve financiare të avancuara që nga viti 1985 dhe me një histori të gjatë në administrimin e fondeve dhe aseteve në 10 vende të Europës Qëndrore dhe Juglindore.

Gjatë vitit 2025, WVP Fund Management Tirana sh.a vijoi aktivitetin e saj me administrimin e dy fondeve të investimit, përkatësisht Fondet WVP Top Invest në monedhën lekë dhe WVP Global në monedhën euro.

Totali i aseteve neto nën administrim të WVP Fund Management Tirana sh.a në fund të vitit 2025, ishte 662,381,089.82 lekë

3. Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Të jemi lider në tregun rajonal të administrimit të fondeve të investimit, duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë për investitorët tanë dhe duke kontribuar në zhvillimin e tregut financiar në Shqipëri dhe rajon.

Misioni

Të rrisim vlerën e investimeve të klientëve tanë, duke realizuar kthime të kënaqshme nga investimet përmes strategjive të diversifikuara dhe të menaxhuara profesionalisht, në përputhje me parimet e integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë.

4. Objektivat Strategjike

- **Transparencë dhe Ndërgjegjësim:** Të sigurojmë komunikim të hapur dhe transparent me investitorët tanë për të rritur ndërgjegjësimin dhe besimin e tyre në shërbimet tona.
- **Diversifikim:** Të ofrojmë një portofol të diversifikuar investimesh që minimizon rrezikun dhe maksimizon kthimin.
- **Zhvillimi Profesional:** Të investojmë në formimin dhe rritjen e vazhdueshme të stafit tonë për të siguruar cilësi të lartë dhe shërbime në përputhje me standardet më të avancuara të industrisë.

- **Inovacion:** Të përmirësojmë vazhdimisht gamën e produkteve dhe shërbimeve tona për t'iu përgjigjur nevojave në zhvillim të investitorëve dhe tregut financiar.

5. Qeverisja Korporative

WVP Fund Management Tirana sh.a është shoqëri aksionere, e organizuar sipas sistemit me një nivel drejtimi, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Këshilli i Administrimit është organi i WVP Fund Management Tirana sh.a, i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit.

Këshilli përbëhet nga:

- **Kryetar:** Mag. Rupert Strobl, gjithashtu President i Bordit të Investimeve me mbi 30 vite përvojë në investime.
- **Anëtar Ekzekutiv/Administrator:** Arton Lena, gjithashtu Zv. President i Bordit të Investimeve.
- **Anëtare Ekzekutive/Zv. Administrator:** Arjola Shegani, gjithashtu Drejtore e Departamentit të Back Office.
- **Anëtar jo Ekzekutiv:** Ardian Kelmendi
- **Anëtar jo Ekzekutiv:** Fatos Kaleshi, gjithashtu Drejtor i Përputhshmërisë.

6. Transparenca

Një nga parimet me të rëndësishme ku bazohet veprimtaria e shoqërisë tonë, është transparenca ndaj investitorit. Ne publikojmë raportet periodike të fondeve tona, ofrojmë përditësime në dokumentacion, informacion të përditësuar mbi NAV, çmimin dhe numrin e kuotave, të cilat mund të shfletohen elektronikisht në faqen zyrtare www.wvpfunds.al. Shoqëria Administruese përlllogarit çdo ditë Vlerën Neto të Aseteve dhe çmimin e fondeve. Pasi i konfirmon këto të dhëna çdo ditë me Bankën Depozitare, i publikon në faqen zyrtare.

Gjithashtu klientët pajisen me kredencialet përkatëse, emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin, për të aksesuar llogaritë e tyre 24/7, duke u njohur me ecurinë e investimit të tyre dhe të kenë mundësi të marrin vendime në kohën e duhur. Kredencialet dërgohen në adresën elektronike të e-mail-it të investitorit.

7. Procesi i Investimit

Administrimi i portofolit të fondit kryhet nëpërmjet një gjykimi të matur e të kujdesshëm, i parë nga i njëjti këndvështrim si ai i administrimit të financave dhe investimeve personale të personelit kyç. Përpyekjet maksimale dhe transparente kryhen për të maksimizuar ruajtjen e kapitalit të investitorëve nëpërmjet aplikimit të masave të kujdesshme, duke treguar gjykim të mirë dhe të matur të riskut pa spekulim, por me synim përfitimi të pastër nga investimi.

8. Konflikti i Interesit

WVP Fund Management Tirana vepron në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhje me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj. Përdor aftësitë dhe dijet e nevojshme, vepron me korrektësi dhe me kujdesin e duhur. Ajo përdor me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë. Gjithashtu, shmang konfliktet e interesit për të garantuar që interesat e investitorëve në çdo sipërmarrje të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve të kenë përparësi mbi interesat e aksionarëve, punonjësve ose personave të lidhur me të.

9. Trajnimet

Gjatë vitit 2025, WVP Fund Management Tirana ka organizuar trajnime për personelin e shitjes dhe agjentëve të WVP Fund Management Tirana. Këto trajnime kanë pasur karakter edukues dhe informues. Gjithashtu, organizohen takime informuese dhe sqaruese me investitorët ekzistues apo potencialë sipas nevojës.

Cdo vit shoqëria organizon eventin “Investor Day”, event ku ka si qëllim kryesor informimin e investitorëve rreth performancës vjetore të fondeve, ngjarjet dhe perspektiva për në vazhdim, si dhe duke zbatuar një nga parimet me të rëndësishme ku bazohet veprimtaria e shoqërisë, transparencën ndaj investitorëve. Në këtë event marrin pjesë Presidenti i Bordit të Investimeve dhe ekipi drejtues i WVP Fund Management Tirana.

10. Fondet e Investimit gjatë vitit 2025

WVP Fund Management Tirana administron dy fonde të përbashkëta investimi WVP Top Invest dhe WVP Global.

Asetet e WVP Global: Fondi investon tërësisht në asete likuide të kompanive më të mëdha në botë. Rrjedhimisht nga ana operationale blerja dhe shitja e portofolit mund të arrihet brenda një kohe shumë të shkurtër (minutash) nga momenti i vendimmarrjes.

Asetet e WVP Top Invest: Fondi investon tërësisht në asete likuide të kompanive më të mëdha në botë. Rrjedhimisht nga ana operationale blerja dhe shitja e portofolit mund të arrihet brenda një kohe shumë të shkurtër (minutash), nga momenti i vendimmarrjes.

Viti 2026 pritet të karakterizohet nga një mjedis ekonomik dhe financiar me sfida të reja, që kërkojnë vëmendje të shtuar ndaj zhvillimeve makroekonomike dhe gjeopolitike:

- **Në Shtetet e Bashkuara**, zbatimi i politikave fiskale dhe tregtare të administratës së re pritet të ndikojë në dinamikën e rritjes ekonomike, nivelin e deficitit buxhetor dhe marrëdhëniet tregtare me partnerët ndërkombëtarë. Këta faktorë mund të sjellin periudha të paqëndrueshmërisë afatshkurtër në tregjet financiare.
- **Në Evropë**, ekonomitë kryesore përballen me sfida të vazhdueshme strukturore, përfshirë rritjen e moderuar ekonomike, presionet demografike dhe nevojën për investime në tranzicionin energjetik dhe dixhital. Politikat monetare pritet të mbeten të kujdesshme, duke ndikuar në kushtet e financimit dhe aktivitetin investues.
- **Në nivel global**, zhvillimet gjeopolitike, tensionet tregtare dhe pasiguritë në zinxhirët e furnizimit dhe tregjet e energjisë mund të ndikojnë në rritjen e volatilitetit në tregjet e kapitalit.
- **Tregjet financiare ndërkombëtare**, pas performancës së fortë të viteve të fundit, pritet të hyjnë në një fazë më të normalizuar të vlerësimeve, ku selektiviteti në përzgjedhjen e investimeve dhe fokusimi në kompani me pozicion të fortë financiar dhe avantazh konkurrues do të mbeten faktorë kyç për krijimin e vlerës afatgjatë.

Pavarësisht sfidave gjeopolitike dhe ekonomike, bizneset ndërkombëtare po performojnë pozitivisht, me rritje të çmimeve dhe fitimeve të kompanive në portofol, çka përforcon pritshmëritë për stabilizim të mëtejshëm të ekonomisë globale.

Bordi investues i qëndroi politikës investuese të aprovuar prej tij, duke u ekspozuar deri në 100% të aseteve të fondit në aksione dhe në këtë mënyrë të përfitonte nga zhvillimi i ekonomisë globale.

Një fond investimi i cili investon vetëm në aksione, është normale të ketë lëvizje sikundër kanë bursat ndërkombëtare, ku kuotojnë aksione të cilat janë në portofol të fondit të investimit.

Fondi WVP Top Invest

WVP Top Invest është fondi i hapur investimi në monedhë lekë.

Asetet e fondit janë të investuara në aksione, të cilët tregtohen në bursat e rregulluara në vende si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Angli, Francë dhe Zvicër.

Objektivi i investimeve të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në tituj të kompanive të mëdha "LargeCaps", në ekonomitë e zhvilluara botërore. Në këtë mënyrë mbajtësit e kuotave, në një afat më të gjatë kohor, do të mund të marrin pjesë në rritjen e ekonomisë botërore dhe të realizojnë fitime nga investimi i tyre.

Komiteti i Investimit ka vendosur që benchmarkun për WVP Top Invest të jetë i kompozuar si më poshtë:

- 30 % Dow Jones Industrial Average Index
- 70 % Stoxx Europe 50 Index

Periudha kohore e cila rekomandohet nga Shoqëria për investim në Fond është së paku 10 (dhjetë) vite, por likuiditeti dhe fleksibiliteti është i garantuar në çdo kohë.

Gjatë vitit 2025 vlera neto e aseteve të fondit WVP Top Invest ka pësuar një rritje të aktiveve neto rreth 8.8%, duke arritur vlerën 252,804,642.87 lekë, ndërsa numri i anëtarëve në fond ishte 368.

Performanca e Fondit

Fondi ka filluar aktivitetin më 29 Mars 2018. Gjatë vitit 2025 fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 5.02% dhe, nga fillimi i aktivitetit të tij deri më 31 Dhjetor 2025 me një normë kthimi neto 21,58%.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kthimet neto historike të fondit WVP Top Invest.



Struktura e Portofolit 31.12.2025



STRUKTURA E PORTOFOLIT 31.12.2025

Qëllimi i Fondit

Fondi është krijuar duke pasur parasysh investitorët që dëshirojnë të kenë një kthim tërheqës dhe zhvillues mritjen gjatë të ekonomisë botërore, veçanërisht në ekonominë më të zhvilluar të botës, si SHBA, Gjermani dhe Zvicër. Qëllimi ynë është të ndërtojmë në portofolin tonë me aksionet e kompanive në indeksin Stoxx Euro 50 dhe DOW, kthimi do të realizohet nëpërmjet investimit të aktiveve të Fondit në aksione të kompanive të mëdha që krijojnë kërkesë gjatë dhe janë forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik. Njëpërmjet investimit në Fond, klientët do të mund të arrijnë diversifikimin e kapitalit të tyre dhe të realizojnë qëllimet e tyre financiare personale, duke pasur shikimet të tjerë të investimit.

* informacioni i detajuar mund të gjendet në Prospekt

Informacion rreth Fondit

Emri i Fondit	WVP Top Invest
Data e krijimit	3/29/2018
Moneda e aksioneve	LEK
Vlera neto	252.804.842,87 ALL
Çmimi për kuotë	1.215,7588
Lloji i fondit	Akumulim
Banka Depozitare	First Investment Bank Albania
Subcustody Bank	First Investment Bank Bulgaria
Benchmark	WVP Benchmark
Devijimi standard	14,99%
Risku	6

Tarifat

Tarifat e paguara nga investitor:

deri në 2.035.000	5,0%
2.035.001 - 3.400.000	4,5%
3.400.001 - 6.800.000	4,0%
6.800.001 - 13.600.000	3,5%
13.600.001 - 34.000.000	3,0%
34.000.001 - 68.000.000	2,5%
68.000.001 - 136.000.000	2,0%
136.000.001 - 340.000.000	1,5%
mbi 340.000.000	1,0%

Komisioni i hyrjes

Tarifa e daljes

nuk ka tarifë (0%)

Tarifat e paguara nga Fondi:

Tarifa e menaxhimit

2% në vit

Tarifa e bankës depozitare

0,2% në vit

Performanca

WVP Top Invest %	WVP Benchmark %	
1M	1,88	-1,00
3M	3,61	2,88
6M	6,01	7,67
1 Year	6,02	7,58
YTD	6,02	7,58


Kthimi total që nga fillimi %

21,58

**WVP Benchmark Calculation : 80 % DOW / 70 % Stoxx Europe 50 - 2,5 % TER

Source of data: The Wall Street Journal

Ekspozimi sipas llojit të instrumentit



Fondi nuk është i listuar në bursë dhe nuk mund të tregohet. Informacioni shtyr, bjerja dhe çiftja e kuotave bëhen direkt përmes WVP Fund Management Tirana. Për blerjen e kuotave të WVP Top

Invest, ndajni letra udhëzuese pagues:

IBAN: AL1821511081ALL1000011282800

SWIFT: FBNVALTR

Report: Struktura e Portofolit të Fondit publikohet në baza trimesore dhe publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë. Kërkimet e publikuesit në raport janë realizuar në të kaluarën dhe duhet të merren si të tilla, por nuk janë garanci për kthimin e ardhshëm. Informacione të detajuara për fondet mund të merren nga Prospekt dhe Statuti i Fondit. Shërbime të klientit në faqen e internetit www.wvpfunds.al, në telefon në +355 (4) 22 24 523 ose në adresën e mëposhtme të emailit: contact@wvpfunds.al


Top 10

ASML Holding NV	4,19%
Microsoft Corp	3,30%
Siemens AG	3,22%
Apple Inc	2,92%
Goldman Sachs Group Inc	2,92%
SAP SE	2,51%
LVMH Moët Hennessy Louis Vuitton SE	2,40%
Roche Holding AG	2,47%
Novartis AG	2,42%
Schneider Electric SE	2,38%
	28,84%


Çmimi për kuotë




Ekspozimi gjeografik



Ekspozimi sektorial



Ekspozimi i monedhës



Fondi WVP Global

WVP Global është fondi i hapur investimi në monedhë Euro.

Asetet e fondit janë të investuara në aksione, të cilët tregtohen në bursat e rregulluara në vende si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Angli, Francë dhe Zvicër.

Objektivi i investimeve të Fondit është realizimi i fitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit, duke investuar në tituj të kompanive të mëdha "LargeCaps", në ekonomitë e zhvilluara botërore. Në këtë mënyrë mbajtësit e kuotave, në një afat më të gjatë kohor, do të mund të marrin pjesë në rritjen e ekonomisë botërore dhe të realizojnë fitime nga investimi i tyre.

Komiteti i Investimit ka vendosur që benchmarkun për WVP Global të jetë i kompozuar si më poshtë:

- 30 % Dow Jones Industrial Average Index
- 70 % Stoxx Europe 50 Index


Periudha kohore e cila rekomandohet nga Shoqëria për investim në Fond është së paku 10 (dhjetë) vite, por likuiditeti dhe fleksibiliteti është i garantuar në çdo kohë.

Gjatë vitit 2025 vlera neto e aseteve të fondit WVP Global ka pësuar një rritje të aktiveve neto rreth 24.93% duke arritur vlerën 409,576,446.95 lekë, ndërsa numri i anëtarëve në fond ishte 475.

Performanca e Fondit

Fondi WVP Global ka filluar aktivitetin më 11.01.2021. Gjatë vitit 2025 fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 7.49 % dhe, nga fillimi i aktivitetit të tij dhe deri më 31 Dhjetor 2025, fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 63,84%.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kthimet neto historike të fondit WVP Global.



Struktura e Portofolit 31.12.2025



STRUKTURA E PORTOFOLIT 31.12.2025

Qëllimi i Fondit

Objektivi i investimit të Fondit është realizimi i fitimeve për investitorët e fondit, duke investuar në parim në tregjet me vlerë të kompanive të mëdha në ekonomitë e zhvilluara të botës, por në disa raste edhe jetësh me vlerë të sponit dhe deponit bankare duke ruajtur një nivel të lartë likuiditeti. Në këtë mënyrë, investitorët e fondit, në termat e afatgjatë, do të mund të marrin pjesë në rritjen e ekonomisë botërore dhe të realizojnë fitime nga investimet e tyre. Ndërkohë investimet në Fond, klientët do të mund të arrijnë diversifikimin e kapitalit të tyre dhe të realizojnë synimet e tyre personale financiare, ndërkohë që kanë likuiditet të lartë të investimit.*

* Informacioni i detajuar mund të gjendet në Prospektin.

Informacion rreth Fondit

Emri i Fondit	WVP Global
Data e krijimit	1/11/2021
Monedha e aksioneve	EUR
Vlera neto	4.232.473,36 EUR
Çmimi për kuotë	163,8449
Lloji i fondit	Akumulimi
Banka Depozitare	First Investment Bank Albania
Subustroty Bank	First Investment Bank Bulgaria Clearstream
Benchmark	WVP Benchmark
Devijimi standard	12,54%
Risku	5
Tarifat	

Tarifat e paguara nga investitorët

deri në 14.999	5,0%
14.999-24.999	4,5%
25.000-49.999	4,0%
50.000-99.999	3,5%
100.000-249.999	3,0%
250.000-499.999	2,5%
500.000-999.999	2,0%
1.000.000-2.499.999	1,5%
mbi 2.500.000	1,0%

Tarifa e daljes

nuk ka tarifë (0%)


Tarifat e paguara nga Fondi:

Tarifa e menaxhimit	2% në vit
Tarifa e bankës depozitare	0,2% në vit

Performanca

WVP Global %	
1M	1,05
3M	4,88
6M	9,80
1 Year	7,49
YTD	7,49
Kthimi total që nga fillimi %	63,84

Ekspozimi sipas llojit të instrumentit



Fondi nuk është i listuar në bursë dhe nuk mund të tregtohet. Informacioni shtyr, blerja dhe shitja e kuotave bëhen direkt përmes WVP Fund Management Tirana. Për blerjen e kuotave të WVP

Global, ndiqni këto udhëzime:
IBAN: AL84 2161 1001 EURI 0000 1480 8100
SWIFT: FWVALT33

Raporti i Strukturës së Portofolit të Fondit publikohet në baza trumjore dhe publikohet në faqen e Internetit të Shoqërisë. Kërkimet e publikuara në raport janë realizuar në të kaluarën dhe duhet të merren si tregues, pra nuk janë garancie për kthimet e ardhshme. Informacione të detajuara për fondet mund të merren nga Prospekti dhe Statuti i Fondit, të publikuar në faqen e Internetit www.wvpfunds.al, në telefon në +355 (4) 22 24 625 ose në adresën e mëposhtme të emailit: contact@wvpfunds.al


Top 10

Nvidia Corp	3,92%
Lam Research Corp	3,58%
Alphabet Inc	3,40%
Facebook Inc	2,91%
Microsoft Corp	2,78%
Johnson & Johnson	2,78%
Allianz SE	2,78%
Applied Materials Inc	2,72%
Philip Morris International Inc	2,71%
Apple Inc	2,65%
	30,23%


Çmimi për kuotë




Ekspozimi gjeografik



Ekspozimi sektorial



Ekspozimi i monedhës



11. Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

WVP Fund Management Tirana sh.a – Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(me raportin e Audituesit të pavarur)

Shoqëria administruese WVP Fund Management Tirana sh.a. përgatit raporte të plota financiare për të gjithë fondet nën administrim, si më poshtë:

- Fondi WVP Top Invest
- Fondi WVP Global

Këto raporte janë të audituara nga RSM Albania sh.p.k dhe mund të shkarkohen dhe lexohen në linkun: <https://wvpfunds.al/wp-content/uploads/2026/05/Pasqyrat-Financiare-31.12.2025-WVP-Fund-Management-Tirana-2-2.pdf>

Në vijim janë paraqitur pasqyrat kryesore financiare për secilin fond

WVP Top Invest- Fond Investimi

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

Pasqyra e pozicionit financiar
Pasqyra e Fitim/Humbje
Pasqyra e Fluksit te Parave
Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto
Pasqyra e ndryshimit në kuotat e fondit
Pasqyra e treguesve të veçantë të fondit të investimit

WVP Top Global- Fond Investimi

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

Pasqyra e pozicionit financiar
Pasqyra e Fitim/Humbje
Pasqyra e Fluksit te Parave
Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto
Pasqyra e ndryshimit në kuotat e fondit
Pasqyra e treguesve të veçantë të fondit të investimit

“WVP Fund Management Tirana” sh.a.

Pasqyrat Financiare më dhe për

vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-26

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe personat e ngarkuar me qeverisjen të WVP Fund Management Tirana Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të WVP Fund Management Tirana Sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Fatian Devija
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 31 Mars 2026



“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Pasqyra e Pozicionit Financiar

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivët Afatgjata			
Aktive Afatgjata Jomateriale	7	997,644	1,027,245
Aktive Afatgjata Materiale	8	2,598,864	2,862,211
Totali i Aktiveve Afatgjata		3,596,508	3,889,456
Aktivët Afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	9	2,522,990	3,617,862
Obligacione	10	26,258,576	26,201,931
Investime ne fonde		2,933,465	2,789,608
Mjete Monetare dhe ekuivalentët me to	11	1,848,652	3,187,352
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		33,563,683	35,796,753
TOTALI I AKTIVEVE		37,160,191	39,686,209
KAPITALI			
Kapitali aksionar	12	28,600,000	28,600,000
Humbje të mbartura		4,307,254	2,763,401
Fitimi i vitit		865,405	4,043,853
Totali i Kapitalit		33,772,659	35,407,254
DETYRIMET			
Detyrimet Afatgjata			
Detyrimet e Qirasë	13	1,177,026	1,663,493
Totali i detyrimeve afatgjata		1,177,026	1,663,493
Detyrimet Afatshkurtra			
Detyrimet e Qirasë	13	513,268	520,588
Detyrim tatim fitimi	23	-	206,675
Llogari të pagueshme	14	1,280,186	1,453,133
Llogari te tjera te pagueshme	15	417,052	435,066
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,210,506	2,615,462
TOTALI I DETYRIMEVE		3,387,532	4,278,955
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		37,160,191	39,686,209

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë “WVP Fund Management Tirana” sh.a. më 05 shkurt 2026 dhe janë firmosur nga:

Z. Arton Lena
 Administrator i Përgjithshëm

Arton Lena

[Signature]



Znj. Rrezarta Qerimi
 Kontabiliste

Rrezarta Qerimi



“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga tarifat e administrimit	16	24,543,753	28,777,916
Të ardhurat nga interesat	17	1,345,099	1,293,592
Shpenzime interesi		(111,436)	(139,937)
Humbje nga ndryshimi i vleres se drejte te investimit ne fonde	18	143,857	197,351
		25,921,273	30,128,922
Shpenzime për personelin	19	(4,894,100)	(4,476,202)
Shpenzime komisioni	20	(10,935,434)	(12,599,830)
Shpenzime të përgjithshme administrative	21	(7,869,046)	(6,537,301)
Shpenzime amortizimi	7,8	(1,265,796)	(973,522)
		(24,964,376)	(24,586,855)
Fitim/(humbja) nga kursi i këmbimit	22	194,749	(616,374)
Fitimi para tatimit		1,151,646	4,925,693
Tatim mbi fitimin	23	(286,241)	(881,840)
Fitimi pas tatimit		865,405	4,043,853
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:		865,405	4,043,853

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali i paguar	Fitimi i mbartur mbartur	Fitimi i periudhës	Totali
Gjendja më 1 janar 2024	28,600,000	1,920,246	2,843,155	33,363,401
Dividendet e shperndare	-	-	(2,000,000)	(2,000,000)
Fitim neto e vitit	-	-	4,043,853	4,043,853
Transferim ne fitimin e pashperndare		843,155	(843,155)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	28,600,000	2,763,401	4,043,853	35,407,254
Dividendet e shperndare	-	-	(2,500,000)	(2,500,000)
Fitim neto e vitit	-	-	865,405	865,405
Transferim ne fitimin e pashperndare		1,543,853	(1,543,853)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	28,600,000	4,307,254	865,405	33,772,659

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Pasqyra e Flukseve Monetare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Flukseve Monetare

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fluksi parasë nga aktiviteti operacional		
Fitimi para tatimit	1,151,646	4,925,694
<i>Rregullime për:</i>		
Të ardhurat nga interesat	17 (1,345,099)	(1,293,592)
Shpenzime amortizimi	7,8 1,265,795	973,522
	1,072,342	4,605,624
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>		
Rritje në llogari të arkëtueshme dhe parapagime	1,094,872	(1,094,787)
Rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	354,446	491,085
Rënie\ Rritje në të pagueshme ndaj aksionarëve		
	2,521,660	4,001,922
Interes i arkëtuar	1,345,099	1,293,592
Tatim fitim i paguar	(1,038,323)	(769,400)
Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar në aktivitetin operacional	2,828,436	4,526,114
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	7 (385,001)	-
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8 (587,847)	(979,629)
Blerje Investime	(143,857)	(200,883)
Blerje Obligacione	(56,644)	198,310
Vënie depozite		
Rrjedhja e parasë neto e përdorur nga aktivitetet investuese	(1,173,349)	(982,202)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		
Rritja e kapitalit		
Pagese dividendi	(2,500,000)	(2,000,000)
Pagesa e Detyrimeve të Qirasë	(493,788)	368,090
Rrjedhja neto nga aktivitetet financuese	(2,993,788)	(1,631,910)
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj	(1,338,701)	1,912,002
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fillim të periudhës	3,187,353	1,275,351
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fund të periudhës	11 1,848,652	3,187,353

